



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Forumi për Transparencë Parlamentare

PLANI I VEPRIMIT PËR KUVEND TË HAPUR

2023-2026

Dhjetor 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Forumi për Transparencë Parlamentare

**PLANI I VEPRIMIT PËR
KUVEND TË HAPUR
2023-2026**

Dhjetor 2022



GLAUK KONJUFCA

Kryetar, Kuvendi i Republikës së Kosovës

—
Që nga miratimi i Deklaratës Globale për Parlament të Hapur në vitin 2015, me ç'rast u themelua Forumi për Transparencë Parlamentare, Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë aktivitete dhe masa konkrete në funksion të rritjes së transparencës parlamentare. Plani i parë i Veprimit për Kuvend të Hapur 2016 – 2020, është përmbyllur suksesshëm, përkundër mungesës së stabilitetit politik gjatë asaj kohe.

Hartimi i Planit të dytë të Veprimit për Kuvend të Hapur, për periudhën 2023-2026, nga Forumi për Transparencë Parlamentare, në përputhje me parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), edhe pse Kosova nuk është ende anëtare e saj, dëshmon përkushtimin tonë institucional, për të promovuar kulturën e transparencës dhe për të rritur llogaridhënien përmes teknologjive të reja, duke iu përshtatur kontekstit në të cilin po jetojmë.

Ky plan paraqet një qasje strategjike ndaj hapjes parlamentare, duke plotësuar kërkesat për hapje që rrjedhin nga Rregullorja e Punës, Plani Strategjik i Kuvendit dhe akteve të tjera.

E veçanta e këtij plani është procesi gjithëpërfshirës i konsultimeve publike me të gjithë hisedarët, i cili i ka paraprirë hartimit të tij. Për më tepër, ky dokument reflekton konsensusin e të gjitha partive politike parlamentare, të cilat përmes përfaqësuesve të tyre në Forumin për Transparencë Parlamentare kanë dhënë kontributin dhe mbështetjen e tyre. Kjo pajtueshmëri e gjerë, jo vetëm në nivel politik, por edhe përtej, është parakusht për përmbushjen e objektivave strategjik të përcaktuar në këtë plan.

Me implementimin e plotë të masave të parapara në këtë plan, ne synojmë që ta rangojmë institucionin e Kuvendit si lider, sa i përket transparencës parlamentare në nivel rajonal. Me anë të këtij plani katërvjeçar, Kuvendi i Kosovës do të zbatojë praktikën globale për përfshirje sa më të gjerë të të gjitha grupeve të shoqërisë në qasjen në informata parlamentare, si një e drejtë themelore për të gjithë qytetarët pa dallim, përmes së cilës mundësohet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje. Po ashtu, do të promovojmë një dialog dhe partneritet konstruktiv me qytetarët, shoqërinë civile dhe mediat për përfshirje në proceset parlamentare dhe për të përmirësuar qasjen e tyre në punën e Kuvendit.

Në funksion të rritjes së llogaridhënies, do të hartojmë Kodin e ri të Etikës për deputetët, që për herë të parë do të krijojë një mekanizëm parlamentar që do të garantojë zbatimin e Kodit për trajtimin e shkeljeve të parimeve dhe normave të etikës parlamentare. Kjo është thelbësore për rritjen e nivelit të llogaridhënies politike dhe besimit të publikut në punën e Kuvendit.

Me gjithë progresin e deritanishëm në avancimin e teknologjisë informative dhe procesit të digjitalizimit në përgjithësi, nëpërmjet këtij plani do të dinamizohet procesi i digjitalizimit të shërbimeve që ofrohen nga Kuvendi, për të lehtësuar bashkëveprimin me Kuvendin dhe me përfaqësuesit e zgjedhur.

Kuvendi i Kosovës është i përkushtuar që të punojë me të gjitha burimet e tij njerëzore, financiare dhe infrastrukturore, për të vazhduar trendin pozitiv në rritje të transparencës dhe forcim të llogaridhënies, digjitalizim dhe gjithëpërfshirje, duke aplikuar praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e hapjes parlamentare. Zbatimi i suksesshëm i këtij plani do të jetë lehtë i arritshëm, me partneritetin efektiv të Kuvendit me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe mediat.



ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI

Kryetare, Forumi për Transparencë Parlamentare

—

Transparenca është hapi i madh drejt demokracisë. Hapja e Kuvendit për publikun, është demokracia vet. Kjo si e tillë është trajtuar nga vet Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili në vitin 2015 themeloi Forumin për Transparencë Parlamentare.

Ky Forum përbëhet nga një deputetë nga secili subjekt politik, nga një përfaqësues i organizatave partner të Kuvendit që mbulojnë fushën e demokracisë, përfaqësues të administratës

së Kuvendit si dhe mbështetet dhe përkrahet nga NDI në Kosovë.

Si kryetare e Forumit, përgjatë kësaj periudhe kohore, kam qenë dëshmitare e një pune të jashtëzakonshme që bëhet nga ana e secilit anëtarë të Forumit dhe më tej, që institucionin më të lartë në vend, pra Kuvendin, ta bëjmë sa më llogaridhënës, sa më transparentë dhe sa më të qasshëm.

Një mori aktivitete të realizuara si brenda poashtu edhe jashtë Kuvendit, bashkëbisedime të shumta me nxënës e qytetarët, debate nëpër Komuna për aktualitetet e tyre, kuizet e diturisë për nxënësit e shkollave fillore, përfaqësimet tona në organizimet ndërkombëtare, kanë qenë rrëfyes i shkëlqyer i asaj se për çfarë më shumë ka nevojë të bëhet dhe çfarë duam të ndryshojmë.

Të gjithë përvojën dhe eksperiencën tonë, e kemi shkrirë brenda Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, versionin përfundimtar të të cilit, po e mbani në duar, pas një pune të gjatë dhe intensive. Të gjitha objektivat dhe masat e parapara me këtë plan, janë hartuar në bazë të parimeve të OGP – Partneriteti për Qeverisje të Hapur, ku të qenurit pjesë e kësaj organizate të madhe botërore, ka qenë dhe vazhdon të jetë qëllim dhe synim i yni.

Kuvendi i Kosovës, në një analizë të bërë së fundi, është ranguar si institucioni i dytë në rajon për të qenurit transparent. Synojmë të bëhemi të parët dhe kjo padyshim do të ndodhë, po vazhduam në intensifikimin e asaj që është bërë deri më tani. Përfshirja sa më e gjerë e grupeve të shoqërisë në qasjen në informata parlamentare, i bënë ata që të jenë aktiv në vendimmarrje. Të qenurit vendimmarrës aktiv, kërkon llogaridhënie dhe përgjegjësi. Të qenurit llogaridhënës dhe përgjegjës na bënë të jemi transparent.

Të jemi transparent dhe të ndërtojmë një institucion që e respekton dhe promovon transparencën është ajo çfarë po e kërkojmë dhe po e promovojmë.

Bashkërisht, duke ecur në drejtimin e duhur, do ta bëjmë të mundur.

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	3
Të arriturat deri më tani	4
Përmirësimi i qasjes në informacion.....	5
1.1 Publikimi i informatave dhe dokumenteve të trupave të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve Parlamentare.....	5
1.2 Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike.....	7
1.3 Publikimi i dokumenteve në formate të hapura.....	8
Pjesëmarrja e qytetarëve, mediave dhe OShC-ve në punën e Kuvendit	10
2.1 Rritja e ndërveprimit mes deputetëve dhe qytetarëve	10
2.2 Lehtësimi i qasjes së OShC-ve në punën e Kuvendit.....	12
2.3 Avancimi i bashkëpunimit me media në ruajtjen e integritetit të informacionit	13
2.4 Avancimi i Programit për Edukim Qytetar	14
2.5 Lehtësimi i qasjes dhe pjesëmarrjes fizike të personave me aftësi të kufizuara	16
2.6 Biblioteka dhe arkivi - të qasshme për studiues dhe hulumtues të dokumentacionit parlamentar	17
2.7 Zgjerimi dhe avancimi i Qendrës së Vizitorëve në Kuvend.....	18
Rritja e llogaridhënies	20
3.1 Hartimi i Kodit të Etikës	20
3.2 Rregullimi ligjor i lobimit.....	22
3.3 Publikimi raporteve periodike e vjetore të detajuara të shpenzimeve të Kuvendit dhe i analizave buxhetore dhe financiare	23
3.4 Përditësimi i Manualit për organizimin e dëgjimeve publike	25
Digjitalizimi dhe avancimi i teknologjisë informative.....	26
4.1 Digjitalizimi i proceseve të punës.....	26
4.2 Ri-funksionalizimi i profileve të deputetëve në ueb faqen e Kuvendit	27
4.3 Funksionalizimi dhe promovimi i platformës E-Pjesëmarrja	28
4.4 Zhvillimi i punës së Kuvendit në distancë gjatë situatave emergjente shtetërore	29

HYRJE

Ky dokument paraqet Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur (Plani) për periudhën 2023-2026 dhe është bazuar në Deklaratën Globale për Parlament të Hapur, të miratuar nga Kuvendi i Republikës Kosovës (Kuvendi) në Maj të vitit 2015, si dhe në rezultatet e vlerësimit të planit të parë për Kuvend të hapur dhe transparent (2016-2020). Dokumenti po ashtu, mëton të promovojë vlerat demokratike dhe standardet e përcaktuara nga Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP), të cilat kanë për qëllim të nxisin proceset parlamentare gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Kuvendi ka shënuar përparim të dukshëm në fushën e transparencës parlamentare, duke zbatuar praktikat globale për përfshirje dhe partneritet më të gjerë të qytetarëve dhe shoqërisë civile në punën e tij. Kështu, sipas hulumtimit regjional të Open Data Kosovo (ODK),¹ Kuvendi në vitin 2019 u rangua në vendin e dytë në rajon për transparencë.

Me hartimin dhe zbatimin e këtij plani, Kuvendi synon të konkretizojë më tej masat të cilat do të ndërmerren me qëllim që në mënyrë graduale të arrijë parimet dhe standardet e transparencës parlamentare, të njohura ndërkombëtarisht. Plani synon të shërbejë si udhërrëfyes për Kuvendin, në përpjekje për të promovuar kulturën e transparencës, për të siguruar qasjen e lehtë dhe me kohë në informatat që ndërlidhen me punën e Kuvendit, rritjen e komunikimit dhe llogaridhënien me publikun, si dhe avancimin e zbatimit të teknologjisë informative, për të rritur ndërveprimin në mes të Kuvendit dhe qytetarëve.

Plani i veprimit është përgatitur nga Forumi për Transparencë Parlamentare (Forum) përmes disa sesione punuese, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe zyrtarëve të administratës së Kuvendit. Po ashtu, Forumi ka organizuar edhe një tryezë diskutimi me përfaqësues të OSHC-ve dhe mediave, për të marrë sugjerime lidhur me avancimin e hapjes parlamentare. Gjatë procesit të hartimit të planit, Forumi është mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), duke mundësuar sesione informuese nga përfaqësues të OGP-së, shkëmbim përvojash me vendet të ndryshme nga regjioni dhe më gjerë, me qëllim të informimit të anëtarëve të Forumit me përvojat e ngjashme nga parlamentet e ndryshme.

Para fillimit të hartimit të Planit, një grup punues në kuadër të Forumit ka bërë një vlerësim të zbatimit të planit të parë të Kuvendit, rezultati i të cilit ka shërbyer si bazë për hartimin e Planit për vitet 2023-2026. Plani përcakton objektivat specifike që duhet të arrihen, veprimet konkrete, indikatorët, afatet kohore, si dhe drejtoritë përgjegjëse dhe organizatat partnere të Kuvendit.

Plani i veprimit do të jetë pjesë e Planit Strategjik të Kuvendit, nga i cili do të burojnë planet vjetore, ku do të përcaktohen edhe implikimet buxhetore. Forumi do të sigurohet që implikimet buxhetore të pasqyrohen në buxhetin e Kuvendit për vitet e ardhshme, dhe do të mbikëqyrë zbatimin e Planit. Me implementimin e masave të parapara në këtë Plan, Kuvendi synon të jetë lider për tërë rajonin sa i përket transparencës parlamentare. Progresi i deritanishëm pritet t'i shërbejë Forumit të intensifikojë përpjekjet për anëtarësimin e Kuvendit në grupin punues për transparencë parlamentare, në kuadër të OGP-së.

¹ <https://opendatakosovo.org/wp-content/uploads/2020/05/Transparenca-e-Parlamentit-te-Kosoves.pdf>

TË ARRITURAT DERI MË TANI

Kuvendi në vitin 2015 miratoi Deklaratën Globale për Parlament të Hapur, e cila ngërthen në vete objektiva dhe indikatorë që shërbejnë si udhërrëfyes se çfarë duhet të promovojnë dhe shtyjnë përpara parlamentet, për të zhvilluar dhe fuqizuar transparencën parlamentare, në përputhje me objektivat globale për qeverisje të hapur. Po ashtu, në të njëjtën kohë themeloi Forumin për Transparencë Parlamentare, i cili përbëhet nga deputetë, zyrtarë të administratës së Kuvendit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët me mbështetje nga NDI-ja hartuan dhe miratuan Planin e Veprimit për një Kuvend të hapur dhe transparent 2016-2020 (Plani). Ky plan ofronte masa konkrete që Kuvendi duhej ndërmarrë, duke u bazuar në katër shtyllat kryesore: qasja në informatat parlamentare, pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në punën e Kuvendit, llogaridhënia dhe avancimi i teknologjisë informative.

Plani për vitet 2016-2020 u miratua nga Kuvendi në vitin 2016, si një nga dokumentet e para që përcaktonte zotimet kryesore të Kuvendit, për promovimin dhe zhvillimin e vlerave të parlamentit të hapur. Përmes planit të hartuar në bashkëpunim OShC-të, Kuvendi krijoi një kulturë të re parlamentare, duke ua lehtësuar qytetarëve qasjen në dokumente dhe informata publike, vizita në objektin e Kuvendit me qëllim të ndërveprimit me deputetët nëpërmjet zbatimit të praktikave të mira si: shënimi i “Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë”, “Ditët e Kuvendit të hapur”, “Punëtoritë për Demokraci - Demos-Ti”, “Kuvendi për Fëmijët”, Programi edukativ “Akademia e mësimdhënësve”, “Ballë-përballë me deputetët” etj.

Po ashtu, ka ngritur bashkëpunimin me media, si në aspektin praktik, përmes lehtësimit të qasjes së tyre në Kuvend dhe ofrimi i informatave, ashtu edhe në aspektin e infrastrukturës ligjore, duke hartuar dhe miratuar Rregulloren për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit, si dhe Strategjinë për Informim dhe Komunikim, e cila në masë të madhe përfshinte edhe edukimin qytetar. Për më tej, me zhvillimin dhe avancimin e teknologjisë informative, Kuvendi ridizajnoi ueb faqen e cila ofron më shumë alternativa informimi për qytetarët mbi aktivitetet parlamentare dhe lehtëson ndërveprimin ndërmjet deputetëve dhe qytetarëve, si për shembull Sistemi Elektronik për Përcjellje të Ligjbërjes, Profilet e deputetëve, platformën “Kuvendi për fëmijët” etj.

Po ashtu, Kuvendi hapi edhe faqen e vet zyrtare në Facebook, si një dritare e re e informimit të drejtpërdrejtë të publikut me punën dhe aktivitetet parlamentare.

Edhe pse në aspektin e transparencës Kuvendi ka shënuar progres, nga vlerësimi i planit paraprak rezulton se rritja e transparencës nuk ka ndikuar sa duhet në përmirësimin e llogaridhënies. Në anën tjetër, masat e ndërmarra për lehtësimin e qasjes, jodomosdoshërisht janë të njohura nga qytetarët, gjë që nevojitet një qasje proaktive për promovimin e punës së Kuvendit.

PËRMIRËSIMI I QASJES NË INFORMACION

1.1 Publikimi i informatave dhe dokumenteve të trupave të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve Parlamentare				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> UNDP			
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ofron të dhëna për përbërjen e Kryesisë dhe një përshkrim të shkurtër për punën e saj. Po ashtu publikon procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, në të cilat përfshihet edhe vendimet dhe përfundimet. Për më tepër, Kuvendi në ueb faqen e tij ofron të dhëna për agjendën ditore apo disa ditore, informata rreth listës së komisioneve parlamentare, përbërjes dhe mbledhjeve të tyre, megjithatë nuk ofron në dispozicion për publikun planet vjetore të komisioneve parlamentare, raportet vjetore dhe raportet e monitorimit të zbatimit të ligjeve në kuadër të mbikëqyrjes parlamentare. Kuvendi ka shënuar progres në gjithëpërfshirje, duke ofruar interpretim të seancave plenare në gjuhën e shenjave, megjithatë nuk ofron dokumentacion apo informata për personat e verbër në alfabetin brail.</p> <p>Kuvendi, gjithashtu ka zhvilluar dhe funksionalizuar Sistemin Elektronik për Përcjelljen e Legjislacionit, ku qytetarët kanë mundësi të përfshihen aktivisht në procesin e ligjbërjes, si dhe ka krijuar qasje në media sociale si “Facebook” dhe ka lansuar profilet elektronike për deputetët. Gjithashtu, në vitin 2019 Kuvendi miratoi edhe Strategjinë për Informim dhe Komunikim për periudhën 2019-2021, e cila përcaktonte masat që Kuvendi duhej të ndërmernte lidhur me informimin e qytetarëve, komunikimit përmes platformave sociale, duke përfshirë edhe “Youtube” dhe kanalet televizive, si dhe përmes përditësimit të ueb faqes.</p>			
Objektiva kryesore:	Ofrimi i informatave të punës së Kuvendit, me qëllim të avancimit të transparencës parlamentare dhe angazhimit më të madh qytetar në proceset parlamentare.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	☐	✓	✓

Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Publikimi i kalendarit dhe programit të punës së sesionit të punës së Kuvendit. ²	<input type="checkbox"/> Publikimi në ueb faqe dhe rrjetet sociale të Kuvendit, në gjuhët zyrtare;	Janar 2023	Korrik 2023
Përzgjedhja dhe përgatitja e informatave dhe dokumentacionit parlamentar	<input type="checkbox"/> Publikimi i të gjitha akteve të miratuara nga Kuvendi; <input type="checkbox"/> Publikimi i planeve dhe raporteve vjetore të komisioneve parlamentare; <input type="checkbox"/> Publikimi i raporteve të punës së komisioneve; <input type="checkbox"/> Publikimi i raporteve të monitorimit të zbatimit të ligjeve; <input type="checkbox"/> Publikimi i raporteve nga vizitat zyrtare.	Janar 2023	Dhjetor 2023
Zhvillimi i infografikave dhe vizualizimeve të informatave dhe dokumenteve parlamentare	<input type="checkbox"/> Publikimi në ueb faqe dhe rrjete sociale të Kuvendit;	Janar 2023	Dhjetor 2023
Krijimi i hapësirës në ueb faqe të Kuvendit për publikim të vjegëzave të raporteve të agjencive të pavarura	<input type="checkbox"/> Publikimi i vjegëzave të raporteve të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi. <input type="checkbox"/> Vendosja e vjegëzave të raporteve të agjencive të pavarura me përshkrimet përkatëse: titulli, data, emri i agjencisë së pavarur etj.	Janar 2023	Dhjetor 2023
Përgatitja e dokumenteve parlamentare në alfabetin brail	<input type="checkbox"/> Publikimi i dokumenteve publike në alfabetin brail.	Janar 2023	Dhjetor 2025

² Rregullorja e Kuvendit, neni 19 p. 2.2 dhe p. 2.3.

1.2 Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike			
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	<input type="checkbox"/> Demokraci Plus		
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike, sipas të cilit institucionet publike detyrohen të publikojnë në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar, në formë elektronike, përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të institucioneve publike, pavarësisht kërkesës së personit për qasje. Në anën tjetër, me miratimin e Deklaratës për Hapje Parlamentare në vitin 2015, Kuvendi është zotuar që informatat parlamentare të jenë dispozicion publik, të jenë sa më të plota, duke pasqyruar tërësinë e veprimit parlamentar, duke iu nënshtruar vetëm përjashtimeve të ngushta dhe të përkufizuara qartë.</p> <p>Në këtë drejtim, Kuvendi ka përcaktuar një person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, tek i cili qytetarët dërgojnë formën standarde të kërkesës për qasje në dokumente publike.</p> <p>Aktualisht Kuvendi harton raportin vjetor për qasje në dokumente publike dhe e dërgon në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.</p>		
Objektiva kryesore:	Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies parlamentare.		
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Teknologji dhe inovacion
	✓	□	□
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike	<input type="checkbox"/> Përgjigjja në kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me ligjin; <input type="checkbox"/> Përgatitja e raporteve periodike nga personi përgjegjës për qasje në dokumente publike; <input type="checkbox"/> Publikimi në ueb faqen e Kuvendit në baza periodike i raportit të kërkesave për qasje në dokumente publike;	Janar 2023	Maj 2023

	<input type="checkbox"/> Zhvillimi dhe publikimi i të dhënave në formë të infografikave.		
--	--	--	--

1.3 Publikimi i dokumenteve në formate të hapura ³				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Open Data Kosovo (ODK)			
Situata aktuale:	<p>Publikimi i regjistrit të votave të deputetëve në seancat plenare, publikimi i raporteve të shpenzimeve, janë ndër të arriturat më të mëdha në aspekt të transparencës, por që duhet të avancohet tutje, duke i publikuar ato në formate të hapura.</p> <p>Një pjesë e konsiderueshme e informatave/dokumenteve publike të Kuvendit publikohen vetëm në formate të mbyllura (PDF), duke ua bërë të vështirë qytetarëve, hulumtuesve dhe organizatave të shoqërisë civile t'i përpunojnë ato të dhëna, për të nxjerrë raporte apo analiza të ndryshme. Andaj, Kuvendi synon që të gjitha informatat apo dokumentet parlamentare t'i publikojë në ueb faqen zyrtare edhe në formate të hapura (Microsoft Excel apo Word). Publikimi i informatave parlamentare në formate të hapura ndikon drejtpërdrejt në rritjen e transparencës dhe besimit të qytetarëve në institucionet publike. Njëkohësisht, mundësimi i shkarkimit të të dhënave drejtpërdrejt nga burimi i tyre, zvogëlon mundësitë e keqinformimit dhe dezinformimit. Po ashtu, informatat parlamentare duhet të përmbliidhen dhe lëshohen në format të hapur të strukturuar, si XML i strukturuar, që mund të lexohet dhe përpunohet nga përdoruesit.</p>			
Objektiva kryesore:	Ofrimi i të dhënave në ueb faqe të Kuvendit në formate të hapura, që të mund të ripërdoren dhe analizohen lehtësisht nga përdoruesit.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhëni e	Teknologji dhe inovacion
	✓	<input type="checkbox"/>	✓	✓

³ <http://opendatahandbook.org/guide/en/appendices/file-formats/>

Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Identifikimi i dokumenteve që mund të publikohen në formate të hapura dhe të përpunueshme	<input type="checkbox"/> Hartimi i listës së dokumenteve që duhet të publikohen në formate të hapura dhe të përpunueshme;	Janar 2023	Qershor 2023
Ruajtja e dokumenteve të identifikuara në formate të hapura dhe të përpunueshme	<input type="checkbox"/> Publikimi i dokumenteve në hapësirat përkatëse në ueb faqe të Kuvendit.	Korrik 2023	Dhjetor 2025

PJESËMARRJA E QYTETARËVE, MEDIAVE DHE OSHC-VE NË PUNËN E KUVENDIT

2.1 Rritja e ndërveprimit mes deputetëve dhe qytetarëve	
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Medie dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale	<input type="checkbox"/> Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata e Shoqërisë Civile
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ka punuar në mënyrë aktive për përfshirjen e shoqërisë civile në politikëbërje dhe vendimmarrje, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto procese. Kuvendi, si institucioni më i hapur në Kosovë, vizitohet nga përafërsisht tetë mijë qytetarë në vit, qoftë përmes vizitave spontane, qoftë për kremtimin e ditëve të veçanta, të përcaktuara në planin e Kuvendit, si: Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, Dita e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Parlamentarizmit, Ditët e Diasporës etj.</p> <p>Shumica e qytetarëve kanë mundësinë të takojnë një deputet kryesisht gjatë fushatave elektorale, por bashkëveprimi me ta është i mangët, duke marrë parasysh sistemin elektoral me një zonë elektorale, si dhe mungesën e zyrave të deputetëve në komunat të tyre. Në këtë drejtim, gjatë planit të kaluar, për të promovuar një Kuvend të hapur dhe gjithëpërfshirës, Kuvendi ka zhvilluar programin “Ditët e Kuvendit”, me ç’rast janë zhvilluar 23 debate në qytete të ndryshme të Kosovës me pjesëmarrje të 73 deputetëve dhe 2105 qytetarëve. Debatet e tilla u ofrojnë mundësinë deputetëve të shpjegojnë dhe argumentojnë qëndrimet e tyre në raport me politikën publike, legjislacionin dhe çështjet tjera të cilat trajtohen në Kuvend, kurse në anën tjetër deputetët kanë mundësinë të bashkëbisedojnë, shprehin shqetësimet dhe kërkesat e tyre tek përfaqësuesit e zgjedhur. Megjithatë, Kuvendi ende nuk ka arritur të krijojë një kalendar periodik dhe të zhvillojë debate të rregullta me qytetarët, gjë që jo vetëm ndihmon Kuvendin të fuqizojë funksionin e tij ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues, por gjithashtu kontribuon në përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje. Andaj, Kuvendi synon të vazhdojë komunikimin e drejtpërdrejtë me qytetarët përmes programit “Ditët e Kuvendit”.</p>
Objektiva kryesore:	Zhvillimi i takimeve të rregullta me qytetarë me qëllim të ndarjes së informatave, promovimit të transparencës dhe rritjes së besueshmërisë në institucionin legjislativ.

Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata <input type="checkbox"/>	Pjesëmarrje qytetare <input checked="" type="checkbox"/>	Llogaridhënie <input checked="" type="checkbox"/>	Teknologji dhe inovacion <input checked="" type="checkbox"/>
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Organizimi i debateve të hapura në mes të deputetëve dhe qytetarëve nëpër komuna	<input type="checkbox"/> Përgatitja dhe publikimi i informatave dhe posterëve në ueb faqe, rrjete sociale të Kuvendit, në faqet zyrtare të komunave dhe në media qendrore e lokale <input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e qytetarëve në debate me deputetët.		Janar 2023	Dhjetor 2026
Organizimi i takimeve në mes të deputetëve dhe studentëve të fushave të ndryshme të studimit në universitetet publike e private në Republikën e Kosovës	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e studentëve në takimet me deputetët.		Shkurt 2023	Dhjetor 2026

2.2 Lehtësimi i qasjes së OShC-ve në punën e Kuvendit ⁴				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale	<input type="checkbox"/> Organizatat e Shoqërisë Civile			
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ka krijuar bazën e të dhënave të organizatave të shoqërisë civile, e cila përmban informata për profilin dhe fushën e ekspertizës për secilën organizatë dhe ndihmon Kuvendin në mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me shoqërinë civile. Megjithatë, kjo data bazë ka nevojë për azhurnim sistematik të të dhënave të OShC-ve. Disa nga OShC-të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta me komisionet në monitorim të implementimit të ligjeve dhe raportet e tyre janë përdorur nga komisionet gjegjëse, por mbetet numër i vogël i OShC-ve të cilat bashkëpunojnë me komisionet në këtë drejtim.</p>			
Objektiva kryesore:	Avancimi i bashkëpunimit me OShC-të, për të pasuruar punën e Kuvendit me burimet dhe ekspertizën e tyre për një Kuvend të hapur dhe llogaridhënës.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	✓	□	✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Rifunksionalizimi dhe përditësimi i databazës së OShC-ve që përcjellin punën e Kuvendit	<input type="checkbox"/> Publikimi i formës për regjistrim të OShC-ve; <input type="checkbox"/> Publikimi i databazës së përditësuar në ueb faqen e Kuvendit;		Janar 2023	Dhjetor 2026
Organizimi i konferencës vjetore me OShC-të për koordinim të objektivave të përbashkëta	<input type="checkbox"/> Përcaktimi i temave të përbashkëta për vitin pasues;		Janar 2023	Dhjetor 2023
Organizimi i sesioneve informuese me përfaqësuesit e	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e përfaqësuesve të OShC-ve të reja në databazën e Kuvendit;		Shtator 2023	Nëntor 2023

⁴ Plani Strategjik i Kuvendit, pika 1.1

OShC-ve lidhur me punën e Kuvendit			
------------------------------------	--	--	--

2.3 Avancimi i bashkëpunimit me media në ruajtjen e integritetit të informacionit

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare
--------------------------------	--

Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:
---------------------------------------	-------------------

<input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> Demokraci Plus (D+) <input type="checkbox"/> Demokraci për zhvillim (D4D) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere
---	--

Situata aktuale:	<p>Keqpërdorimi i informatave për të prodhuar lajme të rreme apo për të sulmuar individë apo grupe të ndryshme për përfitime financiare, materiale apo edhe politike, po kërcënojnë demokracinë në mbarë botën, e ashtu edhe në Kosovë. Për shkak të mospublikimit të të dhënave parlamentare në detaje, apo publikimit të informatave të pjesshme, në disa raste, ka bërë që mediat t'i ofrojnë publikut informata të pasakta apo keqinformuese, duke ndikuar kështu në uljen e besimit të qytetarëve ndaj Kuvendit dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Për të minimizuar këtë fenomen, Kuvendi ka ndërmarrë disa masa për të bashkëpunuar me mediat, duke ofruar hapësirë brenda Kuvendit, duke iu ofruar qasje në të dhëna të kërkuara përmes kërkesave tek personi kompetent për qasje në dokumente publike etj.</p>
-------------------------	---

Objektiva kryesore:	Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe mediave për informim të saktë të qytetarëve mbi punën e Kuvendit dhe ruajtjen e integritetit të informatave që dalin nga institucioni.
----------------------------	---

Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	✓	□	✓

Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Ofrimi i hapësirave të reja për mediat dhe avancimi i bashkëpunimit me mediat	<input type="checkbox"/> Krijimi i këndit/zyrës së veçantë për media;	Janar 2023	Dhjetor 2026
Organizimi i sesioneve informuese në baza periodike mbi integritetin e informacionit, luftimin e	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e përfaqësuesve të mediave në takime të	Janar 2023	Dhjetor 2023

lajmeve të rreme dhe dezinformatave, mënyrën e qasjes në informata parlamentare që duhen për raportim në media tradicionale dhe digjitale;	rregullta dhe sesione diskutimi në Kuvend;		
Zhvillimi dhe realizimi i fushatës edukative dhe vetëdijesuese mbi ruajtjen e integritetit të informacionit	<input type="checkbox"/> Mbajtja e takimeve të rregullta me gazetarë për koordinim të aktiviteteve të përbashkëta; <input type="checkbox"/> Realizimi dhe shpërndarja e fushatës në rrjete sociale dhe media;	Janar 2023	Dhjetor 2026

2.4 Avancimi i Programit për Edukim Qytetar

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale	<input type="checkbox"/> Parlamenti i Austrisë <input type="checkbox"/> Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ka institucionalizuar Punëtoritë për Demokraci “Demos-ti”, një projekt ndërkombëtar i mbështetur për dy vite nga Fondacioni Austriak ERSTE dhe Parlamenti i Austrisë, në partneritet me Kuvendin, i cili ka nxitur interesimin deri tani të rreth 12 mijë nxënësve për njohuri mbi qytetarinë aktive dhe demokracinë, duke zhvilluar tek ata kompetencën e mediave dhe gatishmërinë e shprehjes së mendimit të lirë. Ky projekt, tani në pronësi të Kuvendit, vazhdon të implementohet përmes punëtorive gjysmë ditore, në të cilat nxënësit e klasave 5-9-ta marrin pjesë në krijimin e përmbajtjeve interaktive për tema shoqërore të rëndësishme, si rëndësia e votës, ndarja e pushtetit, roli i deputetëve, qytetaria aktive, funksioni i mediave në demokraci etj. Gjithashtu, si pjesë e punëtorive nxënësit vizitojnë hapësira të ndryshme të Kuvendit, duke nxjerrë gjithashtu revista dhe përgatitur video me njohuritë e fituara për demokracinë.</p> <p>Po ashtu, me mbështetje të NDI-së, Kuvendi ka pilotuar projektin për edukimin qytetar, i cili ka angazhuar 43 mësime të edukatës qytetare të shkollave të mesme të ulëta, në një seri prezantimesh dhe modulesh trajnimit të dizajnuara për të zgjeruar njohuritë rreth kuptimit të demokracisë dhe rolin e Kuvendit në promovimin e qeverisjes së mirë. Si pjesë të Akademisë, mësime të ndryshme kanë organizuar 16 debate në shkollat e tyre përkatëse me deputetë të ftuar, duke u</p>		

	<p>ofruar studentëve një mundësi unike për të bashkëvepruar drejtpërdrejt me përfaqësuesit e zgjedhur. Si aktivitet vijues, janë organizuar 35 vizita të nxënësve në ambientet e Kuvendit të cilët po ashtu kanë marrë pjesë në punëtoritë për demokraci, për të mësuar më shumë për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve, sundimin e ligjit, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, parimet e qeverisjes së mirë dhe rolin e qytetarisë aktive në kultivimin e demokracisë. Ky pilot projekt ka rezultuar tejet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit, gjatë të cilit është evidentuar nevoja për informim dhe edukim të nxënësve lidhur me punën e Kuvendit, si dhe mungesa e materialeve shkollore adekuate për institucionin legjislativ. Gjithashtu, Kuvendi ka krijuar një kënd edukativ për fëmijë në ueb faqen zyrtare të Kuvendit, i cili përmban materiale edukative për nxënës. Megjithatë, nevojitet pasurimi i vazhdueshëm i kësaj platforme. Andaj, Kuvendi synon të prezantojë mundësi të ndryshme për nxënësit, duke përfshirë edhe shkollat e mesme dhe universitetet, me qëllim të zgjerimit të njohurive, si dhe ndërveprime brenda hapësirave të Kuvendit, në hapësira të shkollave nëpër komuna të ndryshme, por edhe në mënyrë digjitale përmes ueb faqes së Kuvendit.</p>			
Objektiva kryesore:	<p>Informimi dhe edukimi i gjeneratave të reja për demokracinë dhe proceset parlamentare, me qëllim të promovimit të kulturës së qytetarisë aktive me pjesëmarrje të të rinjve.</p>			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata ✓	Pjesëmarrje qytetare ✓	Llogaridhënie □	Teknologji dhe inovacion ✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Zhvillimi i programeve edukative me shkolla dhe universitete	<ul style="list-style-type: none"> □ Hartimi i programeve vjetore; □ Sigurimi i hapësirës brenda Kuvendit për mbajtje të aktiviteteve për edukim qytetar; 		Janar 2023	Maj 2023
Zhvillimi i Programit “Punëtoritë për Demokraci - Demos-Ti”	<ul style="list-style-type: none"> □ Pjesëmarrja e nxënësve në punëtoritë për demokraci; □ Prodhimi i materialeve informuese dhe edukuese; □ Zhvillimi i programit për edukimin e fëmijëve mbi integritetin e informacionit; 		Janar 2023	Dhjetor 2026

Organizimi i Akademisë së Mësimdhënësve të lëndës mësimore “Edukata Qytetare”	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e mësimdhënësve të lëndës mësimore “Edukata Qytetare”;	Shtator 2023	Dhjetor 2026
Zhvillimi dhe zbatimi i programit “Ballë për ballë me deputetë”	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e nxënësve në takimet me deputetët; <input type="checkbox"/> Vizitat e nxënësve në Kuvend;	Janar 2023	Dhjetor 2026
Zhvillimi i aktiviteteve edukative në hapësirat e shkollave	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja e nxënësve në simulimet e seancave, takimeve të komisioneve, dëgjimeve publike etj.	Shtator 2023	Dhjetor 2026
Pasurimi i rubrikës “Kuvendi për Fëmijët”	<input type="checkbox"/> Zhvillimi dhe publikimi i materialeve edukative-informuese për fëmijë; <input type="checkbox"/> Zhvillimi dhe publikimi i infografikave dhe videove edukative-informuese për fëmijë; <input type="checkbox"/> Zhvillimi dhe publikimi i udhëzuesve për mësimdhënësit rreth organizimit të aktiviteteve në klasë;	Shkurt 2023	Dhjetor 2026

2.5 Lehtësimi i qasjes dhe pjesëmarrjes fizike të personave me aftësi të kufizuara^{5,6}

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare	
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:	
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Shërbime Teknike <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	<input type="checkbox"/> HANDIKOS <input type="checkbox"/> UNDP <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere	
Situata aktuale:	Kuvendi gjatë zbatimit të Planit të parë të Veprimit ka ndërmarrë hapa konkretë sa i përket përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar. Përveç ofrimit të interpretimit të seancave plenare në gjuhën e shenjave, ka krijuar edhe një infrastrukturë bazike që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje në seancën	

⁵Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006, faqe 5.

https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

⁶ Ligji Nr. 03/L-019 i Republikës së Kosovës për aftësimin, riaftësimin profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, 2009, faqe1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

	plenare. Megjithatë, në objektin e Kuvendit personat në fjalë e kanë të vështirë qasjen në hapësira të tjera të nevojshme, si: tualete të objektit, sallat e mbledhjeve të trupave të Kuvendit, Bibliotekën e Kuvendit etj.			
Objektiva kryesore:	Përmirësimi i qasjes fizike për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat e Kuvendit, për të siguruar gjithëpërfshirje në proceset parlamentare.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata <input type="checkbox"/>	Pjesëmarrje qytetare <input checked="" type="checkbox"/>	Llogaridhënie <input type="checkbox"/>	Teknologji dhe inovacion <input type="checkbox"/>
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Vlerësimi i gjendjes aktuale të infrastrukturës në çdo hapësirë të Kuvendit	<input type="checkbox"/> Hartimi i raportit të vlerësimit të gjendjes aktuale;		Janar 2023	Dhjetor 2023
Përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat e Kuvendit	<input type="checkbox"/> Vendosja e infrastrukturës së nevojshme brenda objektit të Kuvendit;		Janar 2023	Dhjetor 2025

2.6 Biblioteka dhe arkivi - të qasshme për studiues dhe hulumtues të dokumentacionit parlamentar

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Bibliotekë, Arkiv dhe Hulumtime <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	Biblioteka dhe Arkivi i Kuvendi janë të hapura, me kërkesë të palës së interesuar. Palët e interesuara mund të bëjnë kërkime dhe të pajisen me informata që i disponojnë arkivi dhe biblioteka. Arkivi i lajmeve dhe informatave mbi deputetët është funksionale, me përjashtim të procesverbaleve të cilat janë vështirë të qasshme. Aktualisht biblioteka ka një lokacion të papërshtatshëm për lexuesit, ka mungesë të hapësirës dhe është vështirë e qasshme, si dhe duhet të pasurohet me libra fizikë dhe elektronikë.		

	<p>Kuvendi e ka filluar projektin e digjitalizimit të arkivit dhe deri më tani janë digjitalizuar afër 8,000 lëndë arkivore me më se 50,000 faqe. Digjitalizimi është duke u bërë për të gjitha lëndët arkivore që datojnë që nga viti 2001.</p> <p>Audio/Video incizimet ruhen në Arkiv të Kuvendit dhe njëherësh transmetohen drejtpërdrejt në kanalën zyrtar të Kuvendit në “Youtube”, si dhe në ueb faqen e Kuvendit. Të gjitha incizimet nga viti 2018 mund të shikohen në “Youtube” me qasje të lehtë nga përdoruesit.</p>			
Objektiva kryesore:	Digjitalizimi i tërësishëm i arkivit dhe bibliotekës dhe mundësimi i qasjes së qytetarëve në përmbajtje përmes internetit.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	✓	□	✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Themelimi i një grupi punues për vlerësim të gjendjes aktuale	□ Hartimi i raportit të vlerësimit mbi gjendjen aktuale të bibliotekës;		Janar 2023	Shkurt 2023
Pasurimi i bibliotekës me materiale të nevojshme	□ Rritja e numrit të materialeve të disponueshme për shfrytëzuesit e bibliotekës;		Janar 2024	Dhjetor 2026
Finalizimi i procesit të digjitalizimit të arkivit të Kuvendit	□ Vendosja e vjeggës së arkivit digjital në ueb faqen e Kuvendit;		Janar 2024	Dhjetor 2026

2.7 Zgjerimi dhe avancimi i shërbimeve Qendrës së Vizitorëve në Kuvend

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Shërbime Teknike <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	Në shtator të vitit 2012, për herë të parë është hapur Qendra e Vizitorëve. Që nga ajo kohë përmes qendrës, Kuvendin e kanë vizituar mijëra vizitorë të		

	<p>grupmoshave dhe etnive të ndryshme, nga brenda dhe jashtë Kosovës. Duke pas parasysh trendin e rritjes së numrit të qytetarëve të interesuar për të vizituar Kuvendin nga viti në vit, zgjerimi i Qendrës së Vizitorëve është më se i nevojshëm. Me zgjerimin e qendrës do të zhvillohen aktivitete të reja, por edhe të zgjerohen aktualet; si p.sh. simulim i seancave plenare nga nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme, e cila do t'u ofronte një përvojë të veçantë, që përmes praktikës të përjetojnë funksionimin e punës së Kuvendit.</p> <p>Kuvendi, si institucioni më i hapur në Kosovë, vizitohet nga përafërsisht 12 mijë qytetarë në vit, qoftë përmes vizitave spontane, qoftë për kremtimin e ditëve të veçanta, të përcaktuara në planin e Kuvendit, si: Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, Dita e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Parlamentarizmit, Ditët e Diasporës etj.</p>			
Objektiva kryesore:	Zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve të Qendrës së Vizitorëve dhe pasurimi i saj me përmbajtje të reja për vizitorët.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata ✓	Pjesëmarrje qytetare ✓	Llogaridhënie ☐	Teknologji dhe inovacion ☐
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Projektimi ideor për zgjerimin e Qendrës së Vizitorëve.	☐ Hapësirë e disponueshme për qytetarë, media, deputetë etj.;		Janar 2024	Dhjetor 2026
Përgatitja e programeve edukative-informative për punën e Kuvendit;	☐ Informatat rreth historikut të Kuvendit, aktiviteteve, trupave dhe mënyrës së funksionimit, procesit ligjvënës, mënyrave për të marrë pjesë në mbledhje, dëgjimeve publike, kontaktet e deputetëve dhe personelit të Kuvendit, broshura dhe fletëpalosje të dizajnuara për grupe të ndryshme të shoqërisë;		Janar 2024	Dhjetor 2026
Rishikimi dhe plotësimi i programit dhe kalendarit për grupet e organizuara të vizitorëve.	☐ Kalendari dhe programi i aktiviteteve publikohet në ueb faqen e Kuvendit dhe rrjetet sociale;		Janar 2023	Janar 2023

RRITJA E LLOGARIDHËNIES

3.1 Hartimi i Kodit të Etikës				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare <input type="checkbox"/> Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit			
Drejtoria / Personi përgjegjës		Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Hulumtime, Arkiv dhe Bibliotekë <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale		<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	<p>Në planin e kaluar hartimi i Kodit të ri të Etikës nuk është realizuar pasi që parashihej që kjo të ndodhë pas miratimit të Rregullores së re të Kuvendit, duke qenë se Kodi i mirësjelljes ishte pjesë integrale e kësaj rregulloreje. Ky kod kishte të përcaktuar qartë rregullat e sjelljes së deputetëve, megjithatë mungonte një mekanizëm dhe një proces i definuar qartë për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljet e parimeve dhe normave të etikës parlamentare. Tani, me miratimin e Rregullores së Kuvendit, hapet rrugë për hartimin e Kodit të Etikës, për të cilin Kuvendi synon të shqyrtojë modalitete për krijimin e një mekanizmi për sigurimin e zbatimit të mirëfilltë të kodit të etikës sipas standardeve të larta ndërkombëtare.</p>			
Objektiva kryesore:	Rritja e integritetit institucional përmes hartimit dhe zbatimit të mirëfilltë të Kodit të Etikës për Kuvendin e Republikës së Kosovës.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	✓	<input type="checkbox"/>
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Hulumtim mbi praktikat më të mira rajonale dhe botërore	<input type="checkbox"/> Prezantimi i raportit me praktikat më të mira të Kodit të Etikës në vendet e rajonit dhe botës;		Janar 2023	Shkurt 2023
Krijimi i grupit punues për hartimin e Kodit të Etikës	<input type="checkbox"/> Mbajtja e takimeve të rregullta të grupit punues për hartimin e Kodit të Etikës;		Janar 2023	Qershor 2023

	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Shqyrtimi i praktikave më të mira rajonale dhe botërore dhe adoptimi i tyre në kontekstin e Kosovës, duke respektuar Rregulloren e Kuvendit; <input type="checkbox"/> Hartimi i kornizës së Kodit të Etikës duke respektuar Rregulloren e re të Kuvendit; 		
Takime me grupe të interesit për hartimin e Kodit të Etikës	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Organizmi i tryezave dhe takimeve për diskutim mbi përmbajtjen e Kodit të Etikës gjatë procesit të hartimit; <input type="checkbox"/> Shqyrtimi dhe përfshirja e komenteve dhe sugjerimeve të OShC-së në Kodin e Etikës; 	Mars 2023	Qershor 2023
Miratimi dhe publikimi i Kodit të Etikës	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Publikimi i Kodit të Etikës në ueb faqe dhe rrjetet sociale të Kuvendit; <input type="checkbox"/> Krijimi i hapësirës përkatëse për publikimin e raporteve të monitorimit të Kodit të Etikës dhe listën e shkeljeve/shkelësve dhe ndëshkimet e shqiptuara; 	Shtator 2023	Dhjetor 2023
Monitorimi i zbatimit të Kodit të Etikës	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Publikimi i raportit të monitorimit në baza periodike (çdo 6 muaj); <input type="checkbox"/> Publikimi në ueb faqen e Kuvendit i listës së shkeljeve dhe shkelësve të Kodit të Etikës dhe masat e ndëshkimit të shqiptuara për shkelësit në hapësirën përkatëse; 	Janar 2024	Dhjetor 2026

3.2 Rregullimi ligjor i lobimit				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare <input type="checkbox"/> Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Hulumtime, Arkiv dhe Bibliotekë	<input type="checkbox"/> Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere			
Situata aktuale:	Lobimi është veprimtari e ligjshme dhe pjesë e rëndësishme e procesit demokratik. Në një shoqëri demokratike gjithmonë ekziston interesi publik për të siguruar proces lobimi transparent dhe me integritet të plotë. Kosova ende nuk ka një ligj të tillë, ndërkaq format e ushtrimit të ndikimit në vendimmarrje janë të panjohura dhe zhvillohen në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, gjë që edhe nxisin dyshime në procese demokratike dhe për rrjedhojë humbje besimi të qytetarëve në institucionet vendimmarrëse.			
Objektiva kryesore:	Inicimi i rregullimit ligjor të lobimit që do të promovojë transparencën e aktiviteteve lobuese në kontekstin e proceseve parlamentare.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	□	✓	□
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Vlerësim i nevojës për rregullim të lobimit në ligjbërje.	<input type="checkbox"/> Hulumtim parlamentar për vlerësimin e nevojës për ligjin për lobim në ligjbërje; <input type="checkbox"/> Hartimi i raportit të vlerësimit për kryesinë e Kuvendit.		Mars 2023	Qershor 2023

3.3 Publikimi raporteve periodike e vjetore të detajuara të shpenzimeve të Kuvendit dhe i analizave buxhetore dhe financiare

Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Buxhet dhe Financa <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Organizatat partnere		
Situata aktuale:	<p>Në përputhje me Deklaratën për Parlament të Hapur, Kuvendi publikon në mënyrë periodike, në formatin Excel të dhënat e përgjithshme të shpenzimeve të Kuvendit dhe shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit të deputetëve.</p> <p>Megjithëse është shënuar përparim me implementimin e masave të parapara në Planin e parë të veprimit, si p.sh. në profilet e deputetëve janë vendosur vjegëza të deklarimeve të pasurisë nga Agjencia Kundër-Korrupsionit (AKK) dhe është filluar me publikimin e buxhetit dhe raporteve periodike të shpenzimeve, megjithatë Kuvendi synon të publikojë raportet në formate të hapura, si dhe të ofrojë raporte të detajuara duke përfshirë edhe raportet e vizitave zyrtare. Gjithashtu, është e nevojshme që këto raporte financiare të publikohen me informata më të hollësishme dhe për secilin deputet, që do të kontribuonte në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të punës së Kuvendit dhe deputetëve.</p>		
Objektiva kryesore:	Publikimi i detajuar i shpenzimeve të deputetëve dhe të buxhetit të shtetit , përfshirë perspektivën gjinore, me qëllim të rritjes së llogaridhënies parlamentare.		
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Teknologji dhe inovacion
	✓	□	✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Përcaktimi i kategorive të shpenzimeve për publikim	<input type="checkbox"/> Zhvillimi i databazës në bazë të kategorive të shpenzimeve;	Janar 2023	Maj 2023
Krijimi i profilit të shpenzimeve të deputetëve	<input type="checkbox"/> Publikimi i raporteve të shpenzimeve në ueb faqe të Kuvendit në formate të	Maj 2023	Dhjetor 2026

	hapura dhe shpërndarja e tyre në rrjetet sociale;		
Analizimi i buxhetit të shtetit dhe raportit të shpenzimeve publike nga perspektiva gjinore	<ul style="list-style-type: none"> □ Përgatitja dhe publikimi i analizës buxhetore për buxhetin vjetor të RKS nga perspektiva gjinore; □ Përgatitja dhe publikimi i analizës buxhetore për raportin e shpenzimeve të buxhetit vjetor të RKS nga perspektiva gjinore □ Përgatitja dhe publikimi i infografikave të ndryshme mbi performancën e shpenzimeve publike duke u fokusuar në ndikimin sipas gjinisë; 	Tetor 2023	Dhjetor 2026

3.4 Përditësimi i Manualit për organizimin e dëgjimeve publike				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare <input type="checkbox"/> Komisionet parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës		Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun		<input type="checkbox"/> Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	Në vitin 2012 Kuvendi, mbështetur nga NDI, ka hartuar doracakun për organizimin e dëgjimeve publike, i cili ende është në zbatim. Megjithatë, me miratimin e Rregullores së re, është shtuar nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e këtij doracaku.			
Objektiva kryesore:	Avancimi i praktikës për organizimin e dëgjimeve publike me qëllim të përmirësimit të procesit legjislativ dhe mbikëqyrës.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata <input type="checkbox"/>	Pjesëmarrje qytetare <input checked="" type="checkbox"/>	Llogaridhënie <input checked="" type="checkbox"/>	Teknologji dhe inovacion <input type="checkbox"/>
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:	
Hartimi i manualit për dëgjime publike	<input type="checkbox"/> Themelimi i Grupit të Punës; <input type="checkbox"/> Mbajtja e takimeve të grupit punues; <input type="checkbox"/> Përditësimi i manualit;	Mars 2023	Korrik 2023	
Zbatimi në praktikë i manualit	<input type="checkbox"/> Organizimi i sesioneve informuese me stafin përkatës dhe anëtarët e komisioneve;	Mars 2023	Dhjetor 2026	

DIGJITALIZIMI DHE AVANCIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

4.1 Digjitalizimi i proceseve të punës				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informativë <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	<input type="checkbox"/> Organizatat partnere			
Situata aktuale:	<p>Kuvendi ka shënuar progres në përdorimin e teknologjisë informative gjatë viteve 2016-2020, duke realizuar një pjesë të konsiderueshme të objektivave të vendosura në planin e parë të veprimit. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka bërë ridizajnimin e ueb faqes, duke e bërë më lehtë të qasshme dhe interaktive për përdoruesit, dhe duke e krijuar një strukturë më të organizuar të informatave të Kuvendit, si dhe ka krijuar sistemin elektronik për përcjellje të legjislacionit. Kështu, Kuvendi ka krijuar një bazë të fortë digjitale për të vazhduar më tutje me procesin e digjitalizimit të shërbimeve të Kuvendit dhe qasjes më të lehtë në informata publike nga përdoruesit e ueb faqes së Kuvendit. Megjithatë, ka ende hapësirë për të lehtësuar përdorimin e ueb faqes dhe qasjen në informata nga publiku.</p>			
Objektiva kryesore:	Digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen nga Kuvendi, në mënyrë që qytetarët ta kenë më lehtë bashkëveprimin me Kuvendin dhe me përfaqësuesit e zgjedhur.			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektivës		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Hartimi i udhëzimit administrativ për përdorimin e platformës “E-parlamenti” dhe ueb faqes	<input type="checkbox"/> Përdorimi i platformës nga administrata e Kuvendit;		Qershor 2023	Dhjetor 2026
Optimizimi i ueb faqes së Kuvendit	<input type="checkbox"/> Ndërlidhja e komponentëve specifike të platformës “e-parlamenti” dhe platformës së profileve të deputetëve në ueb faqen e Kuvendit;		Janar 2023	Dhjetor 2026

4.2 Ri-funksionalizimi i profileve të deputetëve në ueb faqen e Kuvendit				
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	<input type="checkbox"/> Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere			
Situata aktuale:	<p>Platforma e profileve të deputetëve është zhvilluar gjatë zbatimit të planit të veprimit për vitet 2016-2020, mirëpo nuk është duke u përdorur nga deputetët. Andaj, Kuvendi synon të zhvillojë sesione informuese me deputetët për t'i njoftuar me platformën në fjalë dhe t'iu ofrojë të gjitha njohuritë e nevojshme që deputetët t'i menaxhojnë vet profilet e tyre. Këto profile do të shërbejnë si pasqyrë reale e të arriturave të deputetëve gjatë mandatit të tyre, një lloj CV-je digjitale e qasshme nga të gjithë qytetarët e Kosovës.</p>			
Objektiva kryesore:	<p>Pasurimi i profileve të deputetëve me informata mbi punën dhe angazhimet e tyre si deputetë, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre para qytetarëve.</p>			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhënie	Teknologji dhe inovacion
	✓	☐	✓	✓
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives		Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Azhurnimi dhe integrimi i platformës së profileve të deputetëve	<input type="checkbox"/> Azhurnimi i profileve të deputetëve në platformë duke u bazuar në legjislaturën aktuale;		Janar 2023	Dhjetor 2023
Sesione informimi mbi përdorimin e platformës	<input type="checkbox"/> Organizimi i sesioneve të informimit me deputetët e legjislaturës aktuale mbi përdorimin e platformës dhe menaxhimin dhe përditësimin e profilit të tyre në platformë;		Janar 2023	Dhjetor 2023

	<input type="checkbox"/> Hartimi i manualit për përdorimin dhe menaxhimin e platformës për deputetët;		
--	---	--	--

4.3 Funkcionalizimi dhe promovimi i platformës E-Pjesëmarrja			
Institucioni kompetent:	<input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare		
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:		
<input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative	<input type="checkbox"/> Open Data Kosovo <input type="checkbox"/> Organizata të tjera partnere		
Situata aktuale:	<p>Platforma elektronike për përfshirjen e qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje ka filluar të zhvillohet gjatë zbatimit të planit paraprak të veprimit, por ende nuk është lëshuar në funksion për përdorim nga qytetarët e Kosovës. Duke marrë parasysh nevojën e madhe për një platformë të tillë, Kuvendi duhet të rris përpjekjet që platforma E-pjesëmarrja të funksionalizohet gjatë vitit të parë të planit të ri të veprimit dhe ta promovojë atë tek publiku përmes mediave tradicionale dhe atyre online (Facebook, Twitter, Youtube etj.)</p> <p>Pas funksionalizimit të platformës, Kuvendi duhet të hartojë raporte mbi kërkesat dhe shqetësimet që marrin nga qytetarët karshi çështjeve që parashtrihen për diskutim në kuadër të kësaj platforme, të cilat më pastaj shpërndahen tek deputetët për trajtim në seanca apo komisione parlamentare.</p>		
Objektiva kryesore:	Funksionalizimi i platformës elektronike për pjesëmarrje qytetare, e cila do t'u mundësojë qytetarëve komunikim më të lehtë me përfaqësuesit e tyre.		
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhëni e Teknologji dhe inovacion
	✓	✓	☐
Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Finalizimi dhe lansimi i platformës "E-Pjesëmarrja"	<input type="checkbox"/> Përdorimi i platformës "E-Pjesëmarrja" nga publiku; <input type="checkbox"/> Promovimi i platformës përmes mediave online dhe tradicionale të lajmeve;	Janar 2023	Dhjetor 2026

	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Trajnimi dhe informimi i deputetëve mbi përdorimin e profileve të tyre në platformë; <input type="checkbox"/> Hartimi i raporteve vjetore mbi kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve; <input type="checkbox"/> Numri i kërkesave/shqetësimeve të adresuara nga deputetët në komisionet parlamentare në fund të çdo viti; 		
--	--	--	--

4.4 Zhvillimi i punës së Kuvendit në distancë gjatë situatave emergjente shtetërore				
Institucioni kompetent:	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Sekretari i Përgjithshëm <input type="checkbox"/> Forumi për Transparencë Parlamentare 			
Drejtoria / Personi përgjegjës	Partnerët:			
<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale <input type="checkbox"/> Drejtoria për Teknologji Informative <input type="checkbox"/> Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun 	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Organizatat partnere 			
Situata aktuale:	<p>Kuvendi nuk e ka pasur të rregulluar çështjen e punës në distancë, problem që është identifikuar gjatë pandemisë COVID-19. Rugëzgjdhje këtij problemi i është hapur nga Rregullorja e re e Kuvendit, neni 69, në bazë të së cilit seancat plenare dhe takimet e trupave të Kuvendit mund të zhvillohen në distancë në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme apo emergjencës shtetërore. Në këtë drejtim, Kuvendi duhet të fillojë me krijimin dhe përgatitjen e kushteve hardverike dhe softuerike, që mundësojnë mbarëvajtjen e seancave dhe takimeve të trupave të Kuvendit, si dhe mundëson votimin e sigurt dhe të identifikueshëm të deputetëve.</p>			
Objektiva kryesore:	<p>Sigurimi i mundësive teknologjike për proceset parlamentare me qëllim që seancat plenare dhe takimet e trupave të Kuvendit të mbahen në distancë.</p>			
Përafrimi me vlerat e OGP-së	Qasje në informata	Pjesëmarrje qytetare	Llogaridhëni e	Teknologji dhe inovacion
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

Aktivitetet	Indikatorët e arritjes së objektives	Afati i fillimit të zbatimit:	Afati i fundit për zbatim:
Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe kushteve të nevojshme për punë në distancë	<ul style="list-style-type: none"> □ Hartimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e listës së nevojave për mundësimin e punës në distancë; 	Janar 2024	Dhjetor 2024
Krijimi i kushteve softuerike për mbajtje të seancave plenare dhe takimeve të trupave të Kuvendit	<ul style="list-style-type: none"> □ Përcaktimi i platformave virtuale për video-thirrje që duhet të përdoren nga deputetët për të marrë pjesë në seanca plenare dhe takime të trupave të Kuvendit, në bazë të raportit të vlerësimit; □ Blerja e abonimeve adekuata në platformat e caktuara në bazë të raportit të vlerësimit; □ Zhvillimi i platformës për votim të sigurt për deputetët në bazë të nevojave të dala nga raporti i vlerësimit; 	Janar 2025	Mars 2026
Sesione informuese për deputetët dhe administratën e Kuvendit mbi përdorimin e platformave	<ul style="list-style-type: none"> □ Hartimi i udhëzimeve për përdorim të platformave; □ Përgatitja dhe mbajtja e sesioneve informuese për deputetët dhe stafin e Kuvendit në fillim të çdo mandati legjislativ. 	Prill 2026	Dhjetor 2026



Ky publikim është mundësuar me mbështetjen e popullit zemërgjerë amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Fondit Kombëtar për Demokraci (NED). Qëndrimet e shprehura përmes kësaj publikimi janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID, Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NED.

